

## Termet e Referencës

### Projekti: Zbatimi i masave te EE në sektori privat

#### Hyrje

Efiçienca e Energjisë (EE) konsiderohet nga Qeveria e Kosovës një komponentë thelbësore e planifikimit strategjik dhe ekonomik si dhe për zhvillimin e vendit, prandaj Kosova është përcaktuar që të kontribuojë drejt arritjes së caqeve për EE, duke krijuar për qytetarët stimuj në kursimin e energjisë, por edhe për tregjet e hapura dhe aplikimin e bizneseve të reja për EE teknologjitë.

Si Palë Nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) dhe e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), Kosova është obliguar që ta transpozojë dhe zbatojë rregullativën e Bashkësisë Evropiane që ndërlidhet me Efiçencën e Energjisë. Republika e Kosovës dhe institucionet e saj përgjegjëse në fushën e EE kanë shprehë vullnetin e tyre drejt përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë. Në pajtim me këto obligime, Kosova ka hartuar Planin afatgjatë Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë (PKVEE) 2010-2018 dhe tre plane afatshkurtra që mbulojnë periudhat 2010-2012, 2013-2015 dhe 2016-2018.

Si vazhdimësi e PKVEE 2010-2018, është hartuar Plani i katërt Kombëtar i Veprimit për EE, i cili është në përputhje me obligimet që ka Kosova ndaj Traktatit të Komunitetit të Energjisë, rrjedhimisht ndaj Bashkësisë Evropiane (BE). Ky dokument mbulon periudhën 2019-2021. PKVEE-ja i katërt është dokumenti kryesor i cili përcakton dhe përshkruan veprimet për arritjen e objektivave të politikës shtetërore në fushën e efiçencës së energjisë.

Sa i përket periudhës së ardhshme dhjetëvjeçare, lidhur me sektorin e energjisë në përgjithësi dhe efiçencën e energjisë në veçanti, ndër të tjera, Kosova është duke i hartuar dy dokumente shumë të rëndësishme për zhvillimin e ekonomik:

1. Revidimin e Strategjisë së Energjisë 2017-2026.
2. Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) 2021-2030.

Në drejtim të krijimit të kornizës adekuate ligjore Kosova ka bërë një progres të konsiderueshëm, duke miratuar ligjet (Ligji nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike në Ndërtesa dhe Ligji nr. 06/L-079 për Efiçencë të Energjisë), si dhe legjislacionin sekondar që ndërlidhet me detyrimet nga TKE dhe MSA. Sidoqoftë, mbetin shumë sfida që dalin nga sa u tha më lartë. Në vendin tonë ka pasur përparim të madh në zbatimin e masave EE në sektorin publik, por ende mbetin sfida të tjera që do të adresohen gjatë viteve në vijim, sidomos përmes PKEK 2021-2030.

Sektori privat dhe rezident paraqet një sfidë të madhe, të cilit duhet t'i qasemi me kujdes të veçantë, përmes shfrytëzimit të potencialit vendor, duke mësuar nga përvojat e shteteve me karakteristika dhe vështirësi të ngjashme, qoftë në rajon apo vendet e kontinentit Evropian. Për ta mbështetur këtë sektor, Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë (AKEE) ka planifikuar shpërndarjen e subvencioneve për bizneset private të cilat ndikojnë edhe në sektorin e amvisërisë, sipas kriterëve të përshkruara në kapitujt e mëposhtëm.

## Objektivat e projektit

**Objektivi i përgjithshëm** i këtij projekti është qasja e kontributit nga sektori privat dhe rezident në arritjen e plotësimit të caqeve për EE në Kosovë, që rrjedhin nga obligimet që vendi ynë ka marrë karshi BEs.

Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën 2020, rritjen e stimujve të efijencës së energjisë në sektorët e amvisërisë dhe atë privat, e liston si një ndër të gjeturat dhe sfidat, prandaj edhe rekomandohet që investimeve në këta sektorë t'iu jepet prioritet. Bazuar në këtë, zbatimi i masave të EE në sektorin e amvisërisë dhe bizneseve është paraparë si një objektivat prioritare afatmesme, me qëllim të përmbushjes së obligimeve të dala nga MSA dhe dokumentet e mekanizmat e tjerë të aderimit në BE në kuadër të fushëveprimit të kapitullit 15, me fokus gjatë periudhës 2021 – 2024.

**Objektivi specifik** është që subvencionet të cilat janë planifikuar nga MEA, më specifik nga AKEE në përkrahje të këtij sektori shumë të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të Kosovës, do të kursehen energji elektrike deri në **7,619,010.00kWh/vit** ose **838,091.10euro/vit**, kthimi i investimit do të ndodhë **1,3 vite** gjithashtu do të ndikojnë në ngritjen e vetëdijes te sektori privat për mundësitë e kursimit të energjisë, përdorimin e teknologjive moderne për EE dhe Energjinë e Ripërtërishme dhe rritjes së nivelit të komfortit. Gjithashtu, do të ngritën kapacitetet e akterëve të përshtirë në këtë projekt: bizneset, prodhuesit vendor, ekspertët, instaluesit dhe institucionet publike qeveritare pjesëmarrëse.

Një objektivat tjetër i këtij projekti është edhe kontributi në rimëkëmbjen ekonomike të vendit, pas ndikimit të pandemisë COVID-19 dhe miratimit të Ligjit Nr.07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike - Covid-19.

## Kriteret e vlerësimit

Shuma e përgjithshme financiare e projekteve të planifikuara nga bizneset vendore, në këtë rast instalimi i teknologjive të reja që kursejnë energji elektrike minimum 50% dhe ndriçimit të jashtëm dhe/ose të brendshëm, është planifikuar të jetë rreth 5,000 – 100,000 Euro, ndërsa vlera e subvencioneve nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit/Agjencia e Kosovës për Efijencë të Energjisë do të jete në përqindje prej 70% të vlerës së përgjithshme të projektit ndërsa 30% të vlerës së përgjithshme të projektit obligohet të mbuloj kompania përfituese e grandit.

Shpenzimet për Raportin e Auditimit të energjisë mbuloheh nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit/Agjencisë të Kosovës për Efijencë të Energjisë të cilat janë 5% të vlerës së projektit.

Kriteret teknike për kompanitë e interesuara për subvencione, që duhet dorëzuar në Agjencinë e Kosovës për Efijencë të Energjisë, janë listuar më poshtë:

- Dorëzimi i një koncepti të shkurtë së bashku me planin dinamik dhe metodologjinë e zbatimit të projektit (rreth 2 – 3 faqe).
- Raporti i auditimit energjetik nga një auditor i energjisë i certifikuar me standardin EN 16247 është obligator. Kompania që e zbaton projektin në marrëveshje me përfituesin, duhet të ketë në kuadër të saj së paku një auditor të energjisë/inxhinier i elektroteknikes i

çertifikuar sipas “Rregullores (MEPTINIS ) Nr. 05/2020 për sistemin e ofruesve të shërbimeve energjetike dhe kriteret minimale për auditimin energjetik”. Ky raport duhet të përfshijë edhe specifikacionin teknik, bazuar në kërkesat e veçanta të AKEEs.

- Zbatimi i masave për efikasitet të energjisë duhet të bëhet nga kompania/biznesi përfitues i përzgjedhur nga AKEE, ku përfshihet edhe mbikëqyrja prej fillimit deri në praninë teknik.
- AKEE përgatitë një listë të produkteve që duhet të përzgjidhen për zbatimin e projektit. Këto produkte duhet të jenë në përputhje të plotë me ligjin nr.06/L –079 për Efikasitet të Energjisë neni 9 i këtij ligji dhe “Udhëzimin Administrativ (MEA) Nr.03/2020 lidhur me kërkesat për Efikasitetin e Energjisë për blerjen e produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave nga institucionet e nivelit qendror”.

## Kriteret që duhet të përmbushin produktet e ofruara

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Specifikimet teknike për ndriçuesin LED (trupi ndriçues), janë dhënë më poshtë:** Ndriçuesit janë të destinuara për ndriçimin të brendshëm dhe të jashtëm: Supermarket, Depo, Salla Sporti, Parking.

#### 1. Ndriçues LED për Supermarket - 6480 lm

Emërtimi / Definition	Vlera e kërkuar
<b>Fluxi i dritës i ndriçuesit (lm)</b> Luminous flux (lm)	<b>6480 lm</b> <b>plus minus 2%</b>
<b>Rendimenti i ndriçuesit (lm/W)</b> Luminaire efficacy (lm/W)	<b>180-200 lm / W</b>
<b>Fuqia e instaluar e ndriçuesit (W)</b> Input power (W) Raporti midis fluksit të dritës me rendimentin	<b>Del nga llogaritja e mesiperme</b>
<b>Temperature e dritës T (K)</b> Correlated colour temperature T Unit (K)	<b>= 4000 K ± 5 %,</b> (e bardha neutral/ neutral white)
<b>Indeksi i dhënies së ngjyrave (R)</b> Colour rendering index (R)	<b>Ra &gt; 80</b>
<b>Temperature e ambientit e punës për ndriçuesin (°C)</b> Ambient temperature for luminare (°C)	<b>- 20 °C ~ + 40 °C.</b>
<b>Jetëgjatësia e ndriçuesve LED (h)</b> Usefull life of LED lamps (h)	<b>&gt; 100.000 h (L80 B10)</b>

After 50.000 h LEDs still have 80% of the light (L80), Whereas 10% of bulbs are allowed to have less than 80% (B10)	Pas 100,000 h LED-të kanë 80% të dritës (L80), Ndërsa 10% të llambave më pak se 80% (B10).
<b>Dimimi</b> Dimming LED lamps will be dimmable from 1% - 100%	<b>1-100%</b> Llampat LED do te kenë mundesin te dimueshme nga 1% - 100%
<b>Të dhënat elektrike / Electrical data</b> Tensioni i punes / Rated voltage Frekuenca nominale / Nominal frequency Faktori i energjisë / Power Factor	<b>90- 305 V</b> <b>50 HZ</b> <b>0.95</b>
<b>Raporti i Prodhimit të Dritës së Epërme</b> Upper Light Output Ratio ULOR	<b>&lt; 0.5%</b>
<b>Garancia: Garancia e ndriçuesit</b> Warranty: Lighting guarantee	minimum 5 vjet minimum <b>5 years</b>
<b>Shkalla e mbrojtjes IP</b> Mbrojtje te plote nga depertimi i pluhurit dhe lageshtise. Degree of protection dust penetration-protected	<b>IP 45</b> IEC 60598-1 :2008
<b>Rezistenca minimale ndaj ndikimit (vandalizmi)</b> Impact resistance minimum: (5 J vandal protection)	<b>IK10</b> standard IEC 62262
<b>Izolimi mbrojtjes elektrik</b> Electrical insulation	<b>class II</b> IEC standard
<b>Mbrojtje nga mbitencioni</b> (mbrojtje per dëmtimi nga tensioni i lartë) Protection against high voltage damage	<b>10 kV</b>
<b>Kërkesat e përgjithshme për ndriçuesin LED</b> Llojet e ndriçuesit janë te njohur në nivel Evropian dhe janë marka të certifikuara, për te cilat do të paraqiten certifikatat e konformitetit. Është e detyrueshme për të shënuar shenjen e konformitetit dhe cilësisë CE. Komponentët e dritës si PCB dhe Driver duhet te jene me standard Europiane, duke dëshmuar me specifikacion Teknik nga prodhuesi.	<b>CE</b>
<b>Sistemi i montimit</b> do të lejojë instalimin e lehtë dhe sipas udhëzuesit.	<b>Bulona sipas standardeve te tregut.</b>
Materiali i karkases se ndriçuesit i bërë nga alumini i presuar dhe kursesi i derdhur	-
<b>Material optik / Optic material</b> , duhet te jete sipas standardeve	Xham i temperuar /

te EU-s dhe te jete e qëndrueshme ndaj ndikimeve te jashtme mekanike dhe ndryshimit te temperaturave, te mundesoj shpërndarjen e Dritës sipas projektit te parapar(Simetrike dhe Asimetrike) <b>Optika</b> e parapar ne trupin ndriçues duhet te dëshmohet me Certifikatë CE, si dhe specifikacion Teknik ku tregon qarte shpërndarjen e dritës.	tempered glass
<b>Mesatarja e ndriçimit në LUX – lartësia nga dyshemeja 80cm</b> (Matja do të bëhet në teren pas instalimit të përgjithshëm të ndriçimit me luxmeter nga auditori i energjise.)	450-500 lux

## 2. Ndricues LED për Supermarket - 2200 lm

Emërtimi / Definition	Vlera e kërkuar
<b>Fluxi i drites i ndricuesit (lm)</b> Luminous flux (lm)	<b>2200 lm</b> <b>plus minus 2%</b>
<b>Rendimenti i ndricuesit (lm/W)</b> Luminaire efficacy (lm/W)	<b>180-200 lm / W</b>
<b>Fuqia e instaluar e ndricuesit (W)</b> Input power (W) Raporti midis fluksit te drites me rendimentin	<b>Del nga llogaritja e mesiperme</b>
<b>Temperature e drites T (K)</b> Correlated colour temperature T Unit (K)	<b>= 4000 K ± 5 %,</b> (e bardha neutral/ neutral white)
<b>Indeksi i dhënies së ngjyrave (R)</b> Colour rendering index (R)	<b>Ra &gt; 80</b>
<b>Temperature e ambientit e punes per ndricuesin (°C)</b> Ambient temperature for luminaire (°C)	<b>- 20 °C ~ + 40 °C.</b>
<b>Jetgjatesia e ndricuesve LED (h)</b> Usefull life of LED lamps (h) After 50.000 h LEDs still have 80% of the light (L80), Whereas 10% of bulbs are allowed to have less than 80% (B10)	<b>&gt; 100.000 h (L80 B10)</b> Pas 100,000 h LED-të kanë 80% të dritës (L80), Ndërsa 10% të llambave më pak se 80% (B10).
<b>Dimimi</b> Dimming LED lamps will be dimmable from 1% - 100%	<b>1-100%</b> Llampat LED do te kenë mundesin te dimueshme nga 1% - 100%
<b>Të dhënat elektrike / Electrical data</b> Tensioni i punes / Rated voltage	<b>90- 305 V</b>

Frekuenca nominale / Nominal frequency Faktori i energjisë / Power Factor	<b>50 HZ</b> <b>0.95</b>
<b>Raporti i Prodhimit të Dritës së Epërme</b> Upper Light Output Ratio ULOR	<b>&lt; 0.5%</b>
<b>Garancia: Garancia e ndriçuesit</b> Warranty: Lighting guarantee	minimum <b>5 vjet</b> minimum <b>5 years</b>
<b>Shkalla e mbrojtjes IP</b> Mbrojtje te plote nga depertimi i pluhurit dhe lageshtise. Degree of protection dust penetration-protected	<b>IP 45</b> IEC 60598-1 :2008
<b>Rezistenca minimale ndaj ndikimit (vandalizmi)</b> Impact resistance minimum: (5 J vandal protection)	<b>IK10</b> standard IEC 62262
<b>Izolimi mbrojtjes elektrik</b> Electrical insulation	<b>class II</b> IEC standard
<b>Mbrojtje nga mbitencioni</b> (mbrojtje per dëmtimi nga tensioni i lartë) Protection against high voltage damage	<b>10 kV</b>
<b>Kërkesat e përgjithshme për ndriçuesin LED</b> Llojet e ndriçuesit janë te njohur në nivel Evropian dhe janë marka të certifikuara, për te cilat do të paraqiten certifikatat e konformitetit. Është e detyrueshme për të shënuar shenjen e konformitetit dhe cilësisë CE. Komponentet e dritës si PCB dhe Driver duhet te jene me standard Europiane, duke deshmuar me specifikacion Teknik nga prodhuesi.	<b>CE</b>
<b>Sistemi i montimit</b> do të lejojë instalimin e lehtë dhe sipas udhëzuesit.	<b>Bulona sipas standardeve të tregut.</b>
Materiali i karkases së ndriçuesit i bërë nga alumini i presuar dhe kursesi i derdhur	-
<b>Material optik</b> / Optic material, duhet te jete sipas standardeve te EU-s dhe te jete e qendrueshme ndaj ndikimeve te jashtme mekanike dhe ndryshimit te temperaturave, te mundësoj shpërndarjen e Dritës sipas projektit te parapar (Simetrike dhe Asimetrike) <b>Optika</b> e paraparë ne trupin ndriçues duhet te deshmohet me Certifikat CE, si dhe specifikacion Teknik ku tregon qarte shpërndarjen e drites.	Xham i temperuar / tempered glass
<b>Mesatarja e ndriçimit në LUX – lartësia nga dyshemeja 80cm</b> (Matja do të bëhet në teren pas instalimit të përgjithshëm të ndriçimit me luxmeter nga auditori i energjisë.)	450-500 lux

### 3. Ndricues LED për Depo dhe Parking 11.000 lm-16.000 lm

Specifikimet teknike për ndricuesin LED (trupi ndricues), janë dhënë më poshtë: Ndricuesit janë të destinuara për ndriçimin në rrugë, trotualet, kryqëzimin e këmbësorëve, etj.

Emërtimi / Definition	Vlera e kërkuar
<b>Fluxi i drites i ndricuesit (lm)</b> Luminous flux (lm)	<b>11000-16000 lm</b> <b>plus minus 2%</b>
<b>Rendimenti i ndricuesit (lm/W)</b> Luminaire efficacy (lm/W)	<b>150-170 lm / W</b>
<b>Fuqia e instaluar e ndricuesit (W)</b> Input power (W) Raporti midis fluksit të drites me rendimentin	<b>Del nga llogaritja e mesiperme</b>
<b>Temperature e drites T (K)</b> Correlated colour temperature T Unit (K)	<b>= 5000 K ± 5 %,</b> (e bardha neutral/ neutral white)
<b>Indeksi i dhënies së ngjyrave (R)</b> Colour rendering index (R)	<b>Ra &gt; 80</b>
<b>Temperature e ambientit e punes per ndricuesin (°C)</b> Ambient temperature for luminaire (°C)	<b>- 20 °C ~ + 40 °C.</b>
<b>Jetëgjatesia e ndricuesve LED (h)</b> Usefull life of LED lamps (h) After 50.000 h LEDs still have 80% of the light (L80), Whereas 10% of bulbs are allowed to have less than 80% (B10)	<b>&gt; 100.000 h (L80 B10)</b> Pas 100,000 h LED-të kanë 80% të dritës (L80), Ndërsa 10% të llambave më pak se 80% (B10).
<b>Dimimi</b> Dimming LED lamps will be dimmable from 1% - 100%	<b>1-100%</b> Llampat LED do të kenë mundësin të dimueshme nga 1% - 100%
<b>Të dhënat elektrike / Electrical data</b> Tensioni i punes / Rated voltage Frekuenca nominale / Nominal frequency Faktori i energjisë / Power Factor	<b>90- 305 V</b> <b>50 HZ</b> <b>0.95</b>
<b>Raporti i Prodhimit të Dritës së Epërme</b> Upper Light Output Ratio ULOR	<b>&lt; 0.5%</b>
<b>Garancia: Garancia e ndricuesit</b> Warranty: Lighting guarantee	<b>minimum 5 vjet</b> <b>minimum 5 years</b>
<b>Shkalla e mbrojtjes IP</b> Mbrojtje te plote nga depertimi i pluhurit dhe lageshtise. Degree of protection	<b>IP 45</b> <b>IEC 60598-1 :2008</b>

dust penetration-protected	
<b>Rezistenca minimale ndaj ndikimit (vandalizmi)</b> Impact resistance minimum: (5 J vandal protection)	<b>IK10</b> standard IEC 62262
<b>Izolimi mbrojtës elektrik</b> Electrical insulation	<b>class II</b> IEC standard
<b>Mbrojtje nga mbitensioni</b> (mbrojtje per dëmtimi nga tensioni i lartë) Protection against high voltage damage	10 kV
<b>Kërkesat e përgjithshme për ndriçuesin LED</b> Llojet e ndriçuesit janë të njohur në nivel Evropian dhe janë marka të çertifikuara, për të cilat do të paraqiten certifikatat e konformitetit. Është e detyrueshme për të shënuar shenjen e konformitetit dhe cilësisë CE. Komponentet e dritës si PCB dhe Driver duhet të jenë me standard Europiane, duke deshmuar me specifikacion Teknik nga prodhuesi.	<b>CE</b>
<b>Sistemi i montimit</b> do të lejojë instalimin e lehtë dhe sipas udhëzuesit.	<b>Bulona sipas standardeve të tregut.</b>
Materiali i karkases së ndriçuesit i bërë nga alumini i derdhur.	-
<b>Material optik</b> / Optic material, duhet të jetë sipas standardeve të EU-s dhe të jetë e qëndrueshme ndaj ndikimeve të jashtme mekanike dhe ndryshimit të temperaturave, të mundesojë shpërndarjen e Dritës sipas projektit të paraparë (Simetrike dhe Asimetrike) <b>Optika</b> e paraparë në trupin ndriçues duhet të deshmojë me Certifikatë CE, si dhe specifikacion Teknik ku tregohet qartë shpërndarjen e dritës.	Xham i temperuar / tempered glass
<b>Mesatarja e ndriçimit në LUX – lartësia nga dyshemeja 80cm</b> (Matja do të bëhet në teren pas instalimit të përgjithshëm të ndriçimit me luxmeter nga auditori i energjisë.)	Min 70 lux (Em)

### **Specifikat për teknologjitë e reja që kursejnë energji elektrike**

Instalimi i teknologjive të reja që kursejnë energji elektrike minimum 50%, të prezantohet me katalogë, certifikata e të tjera që dëshmojnë se kursejnë energji elektrike në nivelin minimum A<sup>+</sup>, në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MEA) Nr.03/2020 lidhur me kërkesat për Eficiencën e Energjisë për blerjen e produkteve, shërbimeve dhe ndërtesave nga institucionet e nivelit qendror”

Përzgjedhja e kompanive/bizneseve përfituese bëhet nga komisioni profesional përkatës, bazuar në kriteret e përcaktuara.



## **Mënyra e raportimit të progresit për zbatimin e masave**

Raportet e progresit të projektit bëhen në marrëveshje me AKEEEn, që do të jenë një raport fillestar dhe ai përfundimtar; ky i fundit përshinë masat e parapara për zbatim. Afatet kohore për secilin raport janë mesa vijon:

- Raporti fillestar dorëzohet 20 ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes dy-palëshe.
- Raporti përfundimtar, që nënkupton raportin e komisionit për pranimin teknik, dorëzohet 10 ditë pas pranimit teknik të të gjitha masave EE. Komisioni për pranim teknik përbëhet nga një anëtar prej tri palëve të përfshira në projekt: AKEE, Kompania/biznesi përfitues dhe kompania zbatuese e projektit.

Përmbajtja e raportit iu dorëzohet kompanive/bizneseve përfituese që i kanë plotësuar kriteret.

## **Kohëzgjatja e projektit për subvencione**

Periudha kohore që specifikohet në marrëveshje do të jetë maksimum gjashtë (6) muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes, sipas afateve kohore:

- a) Shpallja e aplikacioneve: me procedurë të shkurtuar për shkak Covid-2019 – 15 ditë kalendarike;
- b) Nënshkrimi i marrëveshjes me kompaninë/biznesin e përzgjedhur, pas plotësimit të kriterëve.
- c) Përfundimi i Projektit: brenda vitit fiskal pas nënshkrimit të marrëveshjes.